

VENDIM
Nr.379, datë 30.11.2005

PËR DHËNIE LICENCE

PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT
“VLORA CHANNEL”

SUBJEKTIT: “VLORA CHANNEL” sh.p.k.

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht për periudhën korrik-gusht, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Vlora Channel” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Vlorës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj